



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST

Janar 2026

Nr. (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	12.01.2026	Kërkesë per informacion ne lidhje me: 1.Cilat janë pikat e përmbushura deri më tani nga Shqipëria në Kapitullin 27 (Mjedisi) në kuadër të procesit të integrimit Evropian? 2.Cilat janë fushat apo pikat specifike të këtij kapitulli, në të cilat shteti shqiptar ende nuk ka nisur ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme? Ju lutem, specifikoni vështirësitë konkrete të hasura gjatë këtij procesi.	23.01.2026	1. Cilat janë pikat e përmbushura deri më tani nga Shqipëria në Kapitullin 27 (Mjedisi) në kuadër të procesit të integrimit Evropian? Shqipëria ka hapur negociatat për Grup kapitullin 4 “Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”, ku bën pjesë dhe Kapitulli 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”. Bazuar mbi ecurinë e reformave legjislativë dhe të zbatimit të legjislacionit mjedisor, Shqipëria nuk ka pasur Piketa Hapëse apo të ndërmjetme por vetëm Piketa Mbyllëse. Këto Piketa Mbyllëse janë dorëzuar zyrtarisht në muajin shtator 2025 pranë Komisionit Evropian dhe tani Shqipëria duhet të ndërmarrë reformat dhe investimet e nevojshme për përmbushjen e këtyre Piketave. 2. Cilat janë fushat apo pikat specifike të këtij kapitulli, në të cilat shteti shqiptar ende nuk ka nisur ndërmarrjen e	Përfunduar	0

		3. Cilat janë standardet mjedisore që vlerësohen si të plotësuara nga shteti shqiptar në kuadër të projekteve për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, inceneratorëve dhe hidrocentraleve?	ndryshimeve të nevojshme? Ju lutem, specifikoni vështirësitë konkrete të hasura gjatë këtij procesi. Kapitulli 27 është shumë i gjerë dhe i ndarë në 10 nënkapituj: Legjislacioni horizontal; Cilësia e ajrit; Menaxhimi i mbetjeve; Cilësia e Ujit; Mbrojtja e natyrës; Ndotja industriale; Kimikatet; Zhurmat; Mbrojtja Civile; Ndryshimet Klimatike. Praktikisht shteti shqiptar ka filluar të ndërmarrë reforma legjislative në të gjithë nënkapitujt ku secili ka ecuri të ndryshme. Vështirësitë janë të mëdha si përsa i përket numrit të madh të akteve ligjore (Acquis) që ka nevojë të përafrohen në legjislacionin shqiptar, nivelit të investimeve që kërkohet të zbatohen për të përmbushur standardet evropiane, si dhe ndryshimi i shpejtë i legjislacionit evropian në fushën e mjedisit. 3. Cilat janë standardet mjedisore që vlerësohen si të plotësuara nga shteti shqiptar në kuadër të projekteve për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, inceneratorëve dhe hidrocentraleve? Këto janë tre fusha të ndryshme që lidhen me tre aspekte të ndryshme: Shqipëria ka disa Impiante të Trajtimit të Ujërave të Përdorura Urbane, por është ende larg standardeve që kërkohen në kuadër të arritjes së standardeve evropiane. Është hartuar një Plan i Posaçëm i Zbatimit të Direktivës Përkatëse ku janë përcaktuar afatet për investimet dhe zonat ku duhen kryer këto investime për të arritur standardet që kërkon direktiva. Inceneratorët kanë të bëjnë me sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe është njëra nga mënyrat sesi menaxhohen mbetjet. Në lidhje me mënyrën sesi do të vazhdohet më tej në lidhje me inceneratorët dhe menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi brenda vitit 2027 do të hartohet një strategji dhe një plan masash në mënyrë që ky sektor të jetë në linjë me kërkesat e Bashkimit Evropian për objektivat e riciklimit dhe uljes së sasisë së mbetjeve. Në lidhje me Hidrocentralet, Ministria e Mjedisit kujdeset që para ndërtimit të tyre të plotësohet dokumentacioni i duhur në përputhje me legjislacionin horizontal, si detyrimi për		
--	--	---	---	--	--

				Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përfshirjen e publikut si në marrjen e informacionit ashtu dhe në vendimmarrje.		
2	21.01.2026	Kërkesë per informacion ne lidhje me: Mbështetur në publikimin e datës 21.01.2026 të faqes zyrtare të Kryeministrit VKM, dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftim dhe konsultim publiku" i ndryshuar kërkohet të përcillet një informacion të detajuar lidhur me procesin e hartimit të projektvendimit "PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM, TË ORGANEVE DREJTUESE E TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE, SH.A", si detyrim i ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" si vijon: 1. Linkun e publikimit në faqen zyrtare; 2. Datën dhe orën e nisjes dhe mbylljes së procesit të konsultimit;	30.01.2026	Projektakti për të cilin kërkohet informacioni, tashmë i miratuar me VKM nr. 37, datë 21.01.2025, është nxjerrë në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 57/2025, i cili ka miratuar de jure krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a., si dhe ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, me qëllim garantimin e funksionimit të saj administrativ dhe institucional. Në këtë kuadër, projektvendimi ka karakter thjesht organizativ dhe zbatues, nuk vendos rregullime të reja normative dhe nuk krijojnë të drejta apo detyrime të reja për subjektet jashtë administratës publike. Për rrjedhojë, duke qënë se ky akt nuk prodhon pasoja të drejtpërdrejta për publikun, si akt administrativ individual, nuk përfshihet në kategorinë e akteve që i nënshtrohen detyrimit për njoftim dhe konsultim publik, bazuar në nenin 4, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 146/2014, i cili parashikon se aktet administrative individuale përjashtohen shprehimisht nga ky detyrim. Për këto arsye, për aktin e sipërcituar, ju informojmë se nuk është zhvilluar proces konsultimi publik, nuk ka link publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, nuk janë përcaktuar data dhe afate të procesit dhe nuk janë administruar mendime apo komente nga ekspertë apo palë të treta.	Përfunduar	0

		3. Mendimet dhe komentet e dhëna nga ekspertët e fushës; 4. Afatet e parashikuar në konsultimin e publikut sipas legjislacionit të sipërcituar.				
3	27.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. A ka një vlerësim aktual të Ministrisë së Mjedisit për nivelin e ndotjes së lumit Drin i Bardhë në territorin shqiptar? Nëse po, ju lutem vendoseni në dispozicion. 2. A ka të dhëna zyrtare për llojin e përqendrimit të ndotësve që hyjnë në Shqipëri përmes lumit Drin nga territori i Kosovës? Nëse po, ju lutem na i vendosni në dispozicion. 3. A ekzistojnë mekanizma apo marrëveshje dypalëshe me Kosovën për monitorimin dhe menaxhimin e ndotjes së lumenjve ndërkufitarë? Rasti konkret ai i Drinit të Bardhë?	30.01.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjme me dije se Agjencia Kombëtare e Mjedisit në mbështetje të VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 për “Rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” pika B 4.1 a-f, B 4.2 a – b, Ç 4-b si dhe në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit realizon <i>“Monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare si dhe ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e tyre”</i>. Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në gjithë territorin e Shqipërisë i ndarë sipas baseneve: Baseni i Drinit, Baseni i Matit, Baseni Ishëm – Erzen, Baseni i Shkumbinit, Baseni i Semanit, Baseni i Vjosës. Baseni i Drinit monitorohet në 7 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij deri para derdhjes në det, ku një nga pikat monitoruese është edhe Drini i Bardhë. Klasifikimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve është kryer bazuar në vlerat limite të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit ku kjo Direktivë i klasifikon ujërat në pesë klasa. “Klasa III” - Gjendja e moderuar, konsiderohet si klasa me nivel minimal të pranueshëm të cilësisë së ujërave. Kampionimi kryhet 4herë/vit dhe vlerësimi i cilësisë realizohet në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit dhe referuar të dhënave monitoruese për vitin 2024 vlerësohet se ky stacion klasifikohet në Klasën II – Gjendje e mirë.	Përfunduar	0

	4. Nëse po, sa prej këtyre janë respektuar apo zbatuar? Nëse keni raporte, ju lutem vendosini në dispozicion. 5. Sa shpesh bëhen matje të përbashkëta të cilësisë së ujit të lumit Drin i Bardhë? A keni rezultate të publikuara? Nëse po, ju lutem vendosini në dispozicion. 6. A ka pasur raste kur ministria shqiptare ka ngritur shqetësime zyrtare ndaj institucioneve homologe në Kosovë për ndotjen e Drinit? Çfarë masash janë marrë? 7. Çfarë veprimesh konkrete po ndërmerret ministria për të ulur ndikimin e ndotjes që vjen nga jashtë territorit shqiptar, konkretisht nga Kosova? 8. A janë rritur kapacitetet e monitorimit dhe kontrollit në pikat kyçe përgjatë Drinit të Bardhë? 9. Cilat janë planifikimet afatshkurtra dhe afatgjata për menaxhimin e mbetjeve të lumit		Përsa i takon kampionimit dhe analizimit, ai kryhet nga Laboratori i AKM (nuk ka matje të përbashkëta) dhe të gjitha të dhënat janë të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM www.akm.gov.al.		
--	--	--	---	--	--

		Drin i Bardhë dhe territorit që ai përshkon?				
4	29.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Cilat masa konkrete ka marrë Ministria e Mjedisit për përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytetet e Shqipërisë, i cili paraqitet në nivele më të larta se normat e Bashkimit Evropian dhe statistikat e vdekshmërisë që lidhen me ndotjen e ajrit janë përkatësisht 3 herë më të larta se BE, dhe nëse keni marrë masa, cili është efekti tyre deri më tani? 3. Sa stacione monitorimi të cilësisë së ajrit janë aktualisht aktive në Shqipëri dhe ku ndodhen? 4. Si i vlerëson Ministria e Mjedisit nivelet e ndotjes së ajrit në Shqipëri krahasuar me standardet kombëtare dhe ato të OBSH-së? 5. A ka Ministria e Mjedisit plane strategjike afatgjata për uljen e ndotjes së ajrit në qytetet dhe zonat industriale?	04.02.2026	1. Cilat masa konkrete ka marrë Ministria e Mjedisit për përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytetet e Shqipërisë, i cili paraqitet në nivele më të larta se normat e Bashkimit Evropian dhe statistikat e vdekshmërisë që lidhen me ndotjen e ajrit janë përkatësisht 3 herë më të larta se BE, dhe nëse keni marrë masa, cili është efekti tyre deri më tani? Lidhur me përmirësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, Ministria e Mjedisit gjatë periudhës 2024-2025, ka ndërmarrë masat si më poshtë: I. Janë miratuar aktet ligjore dhe nënligjore si vijon: 1. Miratimi i Ligjit Nr. 68/2024 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar”, me qëllim ashpërsimin e kundravajtjeve administrative në rast shkeljesh (rritje e gjobave për shkeljet me 30%)”; 2. Miratimi i Urdhërit të Kryeministrit nr. 98, 20.06.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër (KKAP)”, si një strukturë e cila do të koordinojë dhe lehtësojë bashkëveprimin e institucioneve të përfshira në menaxhimin e cilësisë së ajrit në vend; 3. Në zbatim të Ligjit 162/2014, i ndryshuar, janë miratuar Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 21.05.2025 “Për miratimin e formatit që do të përdoret për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis”, si dhe Urdhëri i Ministrit të Mjedisit nr. 189, datë 21.05.2025, “Për miratimin e formatit të raportit tre vjeçar për zbatimin e ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i	Përfunduar	0

			ndryshuar, dhe informacionin që duhet të përmbajë ky raport”. II. Forcimi kapaciteteve teknike institucionale me qëllim rritjen e zbatimit në praktikë dhe forcimin e legjislacionit kombëtar në fushën e cilësisë së ajrit: Gjatë viteve 2024–2025 Shqipëria ka qenë një nga vendet përfituese të mbështetura nga programi rajonal ‘Partneriteti për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Ballkanin Perëndimor’, i zbatuar nga Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit (SwEPA) dhe Instituti Suedez i Meteorologjisë dhe Hidrologjisë (SMHI), në partneritet me UNICEF. Gjatë vitit 2024, përfaqësues të institucioneve Shqiptare që lidhen me fushën e mjedisit dhe cilësinë e ajrit kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në nivel rajonal. Gjatë vitit 2025, disa aktivitete janë organizuar në Shqipëri me qëllim rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore dhe përputhshmërisë me standardet e BE-së për cilësinë e ajrit, përmes proceseve të vlerësimit, menaxhimit dhe raportimit në përputhje me kërkesat e BE-së. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 në kuadër të këtij projekti, janë organizuar trajnime teknike lidhur me inventarët e shkarkimeve dhe planifikimin e cilësisë së ajrit dhe nasat qw duhen marrw. Në këto trajnime kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe njësive të qeverisjes vendore. Pjesëmarrja në këto aktivitete e përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore, është shoqëruar me një rritje të angazhimit nga ana e Bashkive lidhur me detyrimet që ato kanë në fushën e cilësisë së ajrit në territoret e tyre. Psh. Bashkia e Tiranës gjatë vitit 2025 është angazhuar lidhur me hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë e Ajrit.		
--	--	--	---	--	--

			III. Me qëllim promovimin, nxitjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve, qytetarëve apo grupeve të caktuara të interesit, Ministria e Mjedisit, ka bashkëpunuar dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme shoqatat dhe organizatat e ndryshme mjedisore që angazhohen dhe zbatojnë në vendin tonë projekte me fokus përmirësimin e cilësisë së ajrit, ndryshimeve klimatike dhe transportin e qëndrueshëm. Përmendim këtu psh: projektin “Youth for Air Quality”, i zbatuar nga UNICEF Albania me mbështetjen e Sida dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, i cili adreson rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe angazhimin e të rinjve në nëntë bashki, integrimin e temave të cilësisë së ajrit në kurrikulat parauniversitare dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në qeverisjen mjedisore. IV. Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim dhe me institucionet përgjegjëse, është angazhuar dhe ka planifikuar masa konkrete me afate të përcaktuara që lidhen me përafrimin e legjislacionit kombëtar për cilësinë e ajrit në mjedis me acquis-n e BE-së, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e burimeve financiare për zbatimin e tij. Në kuadër të procesit të integritimit dhe me mbështetjen e Projektit ‘SANE27, faza II’, Ministria e Mjedisit ka përgatitur një plan të posaçëm pune për adresimin e piketave mbyllëse për nënkapitullin e Cilësisë së Ajrit. Në vijim dhe duke patur në vëmendje rëndësinë që ka fusha e cilësisë së ajrit në mjedis, Ministria e Mjedisit ka shtuar kapacitetet insitucionale që angazhohen në këtë fushë ku prej Shtatorit 2025 është ngritur një strukturë e dedikuar për cilësinë e ajrit dhe statistikën në mjedis, e përbërë nga një staf prej 5 personash.		
--	--	--	---	--	--

				Në lidhje me forcimin e rrjetit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit në vend, Ministria e Mjedisit i paraqiti Ministrisë së Financave kërkesën buxhetore në vlerën 500 milionë lekë shqiptare (rreth 5,170,000 euro) për zgjerimin e rrjetit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit me 10 stacione shtesë. Me miratimin e Ligjit nr. 87/2025 i cili ka miratuar Buxhetin për vitin 2026, është reflektuar edhe kërkesa e Ministrisë së Mjedisit për buxhetin e kërkuar për zgjerimin e rrjetit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit i cili parashikohet të shpërndahet gjatë periudhës 2026–2028, në 3 faza. Nëpërmjet këtij investimi synohet të përmirësohet infrastruktura kombëtare e monitorimit të cilësisë së ajrit, të forcohet saktësia e të dhënave dhe mbulimi hapësinor, si dhe të sigurojë përputhshmërinë me standardet e BE-së për cilësinë e ajrit. Sa më sipër, Ministria e Mjedisit vlerson se masat e ndërmarra deri më tani në fushën e cilësisë së ajrit kanë sjellë përmirësime në kuadrin ligjor, forcimin e kapaciteteve institucionale për monitorimin e cilësisë së ajrit. Përmirësimi i cilësisë së ajrit është një proces gradual që kërkon kohë, zbatim i vazhdueshëm i politikave është thelbësor për të prodhuar rezultate të matshme dhe të qëndrueshme. 3.Sa stacione monitorimi të cilësisë së ajrit janë aktualisht aktive në Shqipëri dhe ku ndodhen? Aktualisht, cilësia e ajrit matet përmes një rrjeti monitorimi prej nëntë stacionesh të ven-dosura në bashkitë dhe qytetet kryesore: katër stacione në Tiranë (tre fikse dhe një lëvizës) dhe nga një stacion në Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Fier. Stacionet automatike të monitorimit matin monoksidin e karbonit (CO), dioksidin e squ-furit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x), ozonin (O₃), grimcat e pezulluara me diametër më të vogël se 10 mikrometra (PM₁₀) dhe 2.5 mikrometra (PM_{2.5}), si		
--	--	--	--	--	--	--

			dhe benzenin. Përveç kësaj, regjistrohen edhe parametra meteorologjikë si shpejtësia dhe drejtimi i erës, temperatura, lagështia dhe presioni atmosferik. Matjet kryhen me pajisje në përputhje me standardet e BE. Të dhënat nga stacionet automatike i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe përpunimit për të gjeneruar mesatare ditore, mujore dhe vjetore. 4. Si i vlerëson Ministria e Mjedisit nivelet e ndotjes së ajrit në Shqipëri krahasuar me standardet kombëtare dhe ato të OBSH-së? Gjendja e cilësisë së ajrit në bashkitë kryesore të Shqipërisë mbetet jo optimale, veçanërisht për PM10 në të gjitha zonat urbane, kryesisht në dimër kjo si pasojë e përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje. Gjithashtu edhe nivelet e NO2 në stacionin e monitorimit Tirana Higjena (Tiranë) mbeten në vlerat kufi të normave të Bashkimit Europian . Kontribuesit kryesorë që ndikojnë në rritjen e niveleve të NO2 dhe grimcave të pluhurit(PM10,PM2.5) janë trafiku i renduar dhe ndertimi por edhe nga transformimet kimike që ndodhin në atmosferë. Situata për ndotësit e tjetër të monitoruar paraqitet e stabilizuar më ndonjë rritje jo shume të konsiderueshme të O3 në muajt e verës kjo si pasojë e reaksioneve kimike që ndodhin në ajër ne parani të rrezeve UV në zonat rurale. Kjo situatë nxitet nga dy faktorë kryesorë: 1. Urbanizimi i lartë në pjesë të konsiderueshme të zonave bashkiake kontribuon në ndotjen e lartë nga trafiku për shkak të lëvizshmërisë së popullsisë.		
--	--	--	---	--	--

				2. Industria në Elbasanit, Tiranës dhe Fierit. Normat e cilësisë së ajrit në Shqipëri bazohen në standartet e BE-së. VKM nr. 352, datë 29.4.2015 ”Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”, ka transpozuar në legjislacionin Shqiptar Direktivën 2008/50 /EC “Mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Europën”. 5. A ka Ministria e Mjedisit plane strategjike afatgjata për uljen e ndotjes së ajrit në qytetet dhe zonat industriale? Po. Ndër dokumentat dhe planet strategjike afatgjata që lidhen me cilësinë e ajrit përmendim: 1)Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030, identifikon cilësinë e ajrit si prioritet dhe parashikon hartimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit, forcimin e zbatimit të legjislacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. 2) Ministria e Mjedisit, me mbështetjen e projektit SANE27 – Faza II, që nga Shtatori 2024, wshtw angazhuar per rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit në Ambient (miratuar me VKM nr. 594, date 10.09.2014) dhe rishikimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit (miratuar me VKM nr. 412, datë 19.06.2019). Strategjia dhe Plani i ri i hartuar, parashikohen të miratohen nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2026. 3)Ndër dokumentat e tjerë strategjik kombëtar të miratuar në vend dhe që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, përmendim edhe Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, miratuar me VKM nr. 466, datë 3.7.2019 ”Për miratimin e dokumentit Strategjik dhe të Planeve Kombëtare për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”; Planin e Klimes		
--	--	--	--	---	--	--

				dhe Energjise miratuar me VKM nr. 872, datë 29.12.2021; Dokumenti i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar, miratuar me VKM nr. 581, datë 6.10.2021. Në zbatim të detyrimeve në fushën e klimës, Bashkitë Kukës, Elbasan, Krujë, Vlorë, Përmet, Gjirokastrë, Durrës, Fier kanë hartuar, me asistencë të UNDP, Planet lokale te veprimt në fushën e klimës. Ndërkohë me asistencë të GIZ janë në fazë draftimi dhe 14 plane të tjera Lokal		
5	30.01.2026	Në vijim të e-mail të mëposhtëm ku kam kërkuar informacion për procedurën e konsultimit të publikut zhvilluar nga Ministria e Mjedisit për projektvendimin ‘Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a.,’ konstatohen shkelje shumë të rënda në drejtim të kërkesave ligjore si më poshtë vijon: 1. Referuar neni 4 ‘Kufizimet’ në asnjë gërmë të këtij neni nuk përcakton përjashtimin e konsultimit të publikut për një akt ligjor që kërkohet të miratohet me Vendim të Këshill të Ministrave, ndërsa pika 2 gërma a, të këtij neni nuk ekziston në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publiku”, dhe si e tillë vërehet një shkelje shumë e rëndë në interpretim.	06.02.2026	Në vijim të emailit tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Projektakti për të cilin kërkohet informacioni, tashmë i miratuar me VKM nr. 37, datë 21.01.2025, është nxjerrë në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 57/2025, i cili ka miratuar de jure krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a., si dhe ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, me qëllim garantimin e funksionimit të saj administrativ dhe institucional. Në këtë kuadër, projektvendimi ka karakter thjesht organizativ dhe zbatues, nuk vendos rregullime të reja normative dhe nuk krijon të drejta apo detyrime të reja për subjektet jashtë administratës publike. Për rrjedhojë, duke qenë se ky akt nuk prodhon pasoja të drejtpërdrejta për publikun, si akt administrativ individual, nuk përfshihet në kategorinë e akteve që i nënshtrohen detyrimit për njoftim dhe konsultim publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2, si dhe në shkronjën “c” të nenit 4 të ligjit nr. 146/2014, i cili parashikon se aktet administrative individuale përjashtohen shprehimisht nga ky detyrim. Për këto arsye, për aktin e sipërcituar, ju informojmë se nuk është zhvilluar proces konsultimi publik, nuk ka link publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, nuk janë përcaktuar data dhe afate të	Përfunduar	0

		2. Bazuar në pikën 6, të nenit 22 të ligjit nr. 57/2025 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’ në cilin është konceptuar, hartuar, deri në miratim nga Ministria e Mjedisit citon: - Organizimi i brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, dhe si e tillë nuk ka qenë e përcaktuar të përjashtohet nga konsultimi i publikut ky vendim. 3. Bazuar në nenin 7, 8, 9, 18 dhe 19 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publiku”, ka përcaktuar saktësisht hallkat dhe detyrimet që do të ndicen për çdo projektvendim që hartohen në Këshill të Ministrave, dhe si e tillë kërkohet dhe mbajtja e përgjegjësisë për personat të cilët kanë shkelur ligjin e sipërcituar. Mos përfshirja në konsultim të publikut të hartimit të këtij vendimi, ka përcaktuar kritere të	procesit dhe nuk janë administruar mendime apo komente nga ekspertë apo palë të treta.		
--	--	--	---	--	--

		përzgjedhjes e Administratori i shoqërisë “AKEM”, në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 152/2013 ‘Për nënpunësin civil’ i ndryshuar dhe 7961, datë 12.7.1995 ‘Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar dhe si i tillë, nuk do bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit. Nisur sa më lart, kërkohet nga ana juaj rishikimin e këtij vendimi dhe marrjen e masave për personat të cilët kanë vijuar procesin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Mbetem në pritje të kthim përgjigje sipas afateve masat e marra nga Ministria e Mjedisit për gjetjet e konstatuara.				
6	03.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1.A është ngritur dhe funksionon aktualisht Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër (KKAP), i krijuar me Urdhrin nr. 98, datë 20.06.2024?		Ne proces		

		2. Cila është përbërja e këtij Komisioni (institucionet dhe emrat e anëtarëve)? 3. Sa mbledhje ka zhvilluar KKAP që nga krijimi i tij e deri më sot dhe në cilat data? 4. A janë hartuar raporte, analiza apo dokumente zyrtare mbi gjendjen e cilësisë së ajrit nga KKAP? Nëse po, do ju lutesha për kopje të tyre.				
7	03.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. A është aktualisht e lejuar gjuetia në Shqipëri dhe cili është logji ose akti ligjor që e rregullon atë? 2. Cilat janë zonat ku lejohet ushtrimi i gjuetisë dhe a ekziston një listë ose hartë zyrtare e publikuar e këtyre zonave? 3. A janë dhënë zona gjuetie për menaxhim subjekteve private? 4. Nëse po, me çfarë procedure janë dhënë, për çfarë afati kohor, mbi bazën e cilave kriteret?	06.02.2026	1. A është aktualisht e lejuar gjuetia në Shqipëri dhe cili është logji ose akti ligjor që e rregullon atë? Gjuetia është e rregulluar me ligjin Nr. 89/2025 “PËR GJUE TINË” 2. Cilat janë zonat ku lejohet ushtrimi i gjuetisë dhe a ekziston një listë ose hartë zyrtare e publikuar e këtyre zonave? Gjuetia zhvillohet vetëm në zonat për ushtrimin e gjuetisë që përfshihen në fondin pyjor dhe kullësor jashtë territorit të zonave të mbrojtura, në tokat bujqësore, në sipërfaqet ujore të brendshme, në toka të pafrytshme, të populluara me lloje të faunës së egër, objekt gjuetie, dhe shtrihen në sipërfaqe që janë me pronësi shtetërore apo private. Zonat e gjuetisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë, Aktet nënligjore do të hartohen brenda 3. A janë dhënë zona gjuetie për menaxhim subjekteve private?	Përfunduar	0

		5. Cilat janë speciet e kafshëve të egra që lejohet të gjuhet dhe cilat janë speciet e mbrojtura me ligj? 6. Si përcaktohen periudhat e gjuetisë, kuotat ose kufizimet për speciet e lejuara dhe me cilat akte miratohen ato? 7. Cilat institucione janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së gjuetisë dhe cilat janë masat ndëshkuese të parashikuara në rast shkeljesh.	Jo 4. Nëse po, me çfarë procedure janë dhënë, për çfarë afati kohor, mbi bazën e cilave kritere? 5. Cilat janë speciet e kafshëve të egra që lejohet të gjuhet dhe cilat janë speciet e mbrojtura me ligj? Nuk janë përcaktuar ende se cilat specie do të jene objekt gjuetie, llojet te cilat janë te mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë të listuar në Urdhrin 1280 datë 20.11.2013 “Për miratimin e listës se kuqe te florës dhe faunës se egër”. 6. Si përcaktohen periudhat e gjuetisë, kuotat ose kufizimet për speciet e lejuara dhe me cilat akte miratohen ato? Gjuetia do te ushtrohet vetëm brenda sezonit të hapur për gjueti, duke respektuar periudhën e riprodhimit, derisa të vegjlit të ndahen nga nëna, si dhe periudhën e foljezimit, derisa të vegjlit të mësojnë të fluturojnë. Sezoni i hapur për gjueti përcaktohet sipas kritereve gjeografike, klimatike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë. Për çdo vit ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj zyrtare. Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve, si dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të ministrit. Dita e gjuetisë fillon pas lindjes së diellit dhe përfundon me perëndimin e tij. 7. Cilat institucione janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së gjuetisë dhe cilat janë masat ndëshkuese të parashikuara në rast shkeljesh.		
--	--	--	--	--	--

				· Kontrolli dhe inspektimi për gjuetinë kryhen nga struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin. · Struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me strukturat e policisë bashkiake, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për policinë bashkiake. · Për çdo rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin, si dhe mbahet një procesverbal që nënshkruhet nga hartuesi, shkelësi dhe dëshmitari i pranishëm dhe, në mungesë të dëshmitarit, procesverbali është i vlefshëm vetëm me nënshkrimin e menaxhuesit të zonës së gjuetisë apo të inspektorit të organeve të kontrollit. · Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret gjuetarit, armët e mjetet e gjahut sekuestrohen me procesverbal dhe i dorëzohen Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi ka likuiduar gjobën përkatëse. · Masat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni përbëjnë masa plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë ose ndëshkime të tjera të parashikuara në ligj.		
8	04.02.2026	Kërkesë per informacion ne lidhje me: Prokuroria e Durrësit pas kthimit të përgjigjeve nga laboratorët italianë vërtetuan se mbetjet e		Ne proces		

		ndodhura në 102 kontejnerët në Porto Romano janë me përbërës “mbetje të rrëzikshme”. Si do të veproni në këtë rast. Çfarë do të bëhet me rreth 2800 ton mbetje? -A keni një projekt për asgjësimin e tyre, ose dërgimin në bazë të regullave dhe kushteve specifike në një shtet tjetër i cili përpunon mbetje të tilla? -Nëse keni një projekt, sa është kosto financiare? -Deri në zgjidhjen e plotë të këtij rasti, a keni kryer verifikim në çfarë kushtesh po mbahen mbetjet dhe a ka rrezik kontaminimi në zonë?				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndhmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.